



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA  
GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC

---

Numri i lëndës: 2023:127466  
Datë: 26.03.2024  
Numri i dokumentit: 05506012

**C.nr.504/2023**

**GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil**, gjyqtari **Betim Behluli**, në çështjen juridike të paditësve **R.H** nga fshati Gexhë, komuna Rahovec, **F.M** nga fshati Dejnë, Komuna Rahovec dhe **B.M** nga Gjakova, të cilët i përfaqëson përfaqësuesi i tyre i autorizuar avokati **D.M** nga Prizreni, sipas autorizimit në shkresat e lëndës, kundër të paditurës Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, të cilën e përfaqëson përfaqësuesi ligjor avokat **B.O.**, sipas autorizimit në shkresat e lëndës, për shkak të kompensimit të shpërblimit jubilar, vlera e kontestit 842.00 €, jashtë seance, më 26.03.2024, merr këtë:

### **A K T G J Y K I M**

**APROVOHET** padia dhe kërkesëpadia e paditësve **R.H, F.M** dhe **B.M** në tërësi si e bazuar si dhe:

**DETYROHET** e paditura Komuna e Rahovecit-Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditësve t’u paguaj kompensim për shpërblim jubilar, si vijon:

- Paditësit **R.H** në emër të kompensimit për shpërblim jubilar për 20 vite të përvojës së punës ti paguaj shumën prej 315.75€ (75% të pagës bazë prej 421,00 €).
- Paditëses **F.M**, në emër të kompensimit për shpërblim jubilar për 20 vite të përvojës së punës ti paguaj shumën prej 315,75€ (75% të pagës bazë prej 421.00 €),
- Paditësit **B.M** në emër të kompensimit për shpërblim jubilar për 10 vite të përvojës së punës ti paguaj shumën prej 210.50€ (50% të pagës bazë prej 421,00 €) si dhe shumën e përgjithshme për të gjithë paditësit prej gjithsejtë 842,00€, të gjitha me kamatë ligjore prej 8%, duke e llogaritur nga prej ditës së paraqitjes së padisë (06.06.2023), e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, pas pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përbarimit të dhunshëm, **SI ME BAZË**.

**DETYROHET** e paditura që në po të njëjtin afat, paditësit t’i paguaj edhe shpenzimet procedurale në shumë prej 229.00 € me kërcënim të përbarimit të dhunshëm.

### **A r s y e t i m**

Paditësit **R.H, F.M** dhe **B.M**, nëpërmjet përfaqësuesit të tyre të autorizuar me datë 06.06.2023 kësaj gjykate i kanë ushtruar padinë, kundër të paditurës Komuna e Rahovecit - Drejtoria Komunale e Arsimit, për shkak të kompensimit të shpërblimit jubilar.

Të njëjtit sipas padisë kanë theksuar se kanë punuar dhe vazhdojnë të punojnë në SH.F.M.U “Skender Kastrati” në fshatin Radostë, Komuna e Rahovecit, të sistemuar në vendin e punës si punëtor teknik dhe mësimdhënës dhe atë me kontratë pune. Më tej kanë shtuar se e paditura në bazë të Kontratave Kolektive ka qenë e obliguar që paditësve tua paguajë shpërblimin jubilar për 75% dhe 50% pagës bazë, duke i propozuar gjykatës që kërkesëpadinë e paditësve ta aprovojë në tërësi dhe ta detyrojë të paditurën në pagesën e kompensimit për shpërblimin jubilar.

E paditura Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, në përgjigjen e saj në padi të datës 21.12.2023, ka theksuar se e kontestojmë padinë në tërësi për shkak se Kontrata Kolektive e Arsimit e datës 17.04.2017 ka qenë në fuqi deri më 21.04.2021. Me rastin e lidhjes së kontratave kolektive në nenin 2 të dy kontratave janë deleguar kompetenca dhe detyrime për të paditurën pa u shoqëruar edhe me buxhet shtesë, këto detyrime nuk janë zbatuar nga niveli qendror i pushtetit. Andaj, e konteston kërkesëpadinë e paditësve pasi që i mungon legjitimiteti real-pasiv për faktin se komunitat kanë kompetenca vetanake, të zgjeruara dhe të deleguara në pajtim me ligjin, autoriteti shtetëror që delegon kompetencat, përballon shpenzimet për ushqimin e delegimit. Duke shtuar se kërkesa në kuptim të nenit 87 të Ligjit të Punës, është parashkuar. Andaj i ka propozuar gjykatës që kërkesëpadinë e paditësve ta refuzoj tërësisht si të pa bazuar ndaj të paditurës Komuna Rahovecit.

Për të vërtetuar faktet vendimtare në lidhje me këtë çështje kontestimore, gjykata i ka zbatuar provat duke bërë shikimin e tyre, për paditësin **R.H** ka bërë shikimin në ; kontratën e të datës 01.09.2015, e lidhur ndërmjet Komunës së Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit dhe paditësit R.H; lista e pagës për muajin Tetor 2022; për paditësin **F.M** kontratën e punës për mësimdhënës me Nr.të protokollit 01/1404 e datës 01.09.2015 e lidhur ndërmjet Komunës së Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit dhe paditëses F.M dhe lista e pagës për muajin Tetor 2022; për paditësin **B.M** kontratën e punës për mësimdhënës me Nr.të protokollit 01 e datës 01.09.2015 e lidhur ndërmjet Komunës së Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit dhe paditësit B.M dhe lista e pagës për muajin Tetor 2022;

Pas analizimit dhe vlerësimit të secilës provë veç e veç dhe të gjitha së bashku, bazuar në dispozitat të neneve 7 dhe 8 të LPK-së, duke i vlerësuar deklaratimet e ndërgjyqësve dhe në bazë të bindjes së vetë të lirë, është konstatuar se kërkesëpadija e paditësve është e bazuar dhe e njëjta është aprovuar.

Gjatë procedurës së provave, kjo gjykatë si provë të veçantë, ka proceduar listën e përvojës së punës për të gjithë paditësit, me të cilën vërtetohet se paditësit kanë përvojë pune si në vijim: paditësi R.H ka gjithsej 20 përvojë pune, paditësja F.M ka gjithsej 20 vite përvojë pune si dhe paditësi B.M ka gjithsej 12 vite përvojë pune.

Me administrimin e kontratës së punës për punëtor teknik e datës 01.09.2015, të lidhur ndërmjet paditësit R.H dhe të paditurës, gjykata vërtetoi faktin se paditësi ka kontratë pune me të paditurën dhe i njëjti është e sistemuar në vendin dhe me detyrat e punës në SH.F.M.U “Skender Kastrati” në fshatin Radostë, Komuna e Rahovecit.

Me administrimin e listës së pagës për muajin Tetor 2022, gjykata vërtetoi faktin se paditësi R.H ka përvojë pune 20 vjeçare.

Me administrimin e kontratës së punës për mësimdhënës me Nr.të protokollit 01/1404 e datës 01.09.2015, të lidhur ndërmjet paditëses Drita Ibrahimimi dhe të paditurës, gjykata vërtetoi faktin se paditësja ka kontratë pune me të paditurën dhe e njëjta është i sistemuar në vendin dhe me detyrat e punës në SH.F.M.U “Skender Kastrati” në fshatin Radostë, Komuna e Rahovecit.

Me administrimin e listës së pagës për muajin Tetor 2022, gjykata vërtetoi faktin se paditësja Drita Ibrahimimi ka përvojë pune 20 vjeçare.

Me administrimin e kontratës së punës për mësimdhënës me Nr.të protokollit 01 e datës 01.09.2015, të lidhur ndërmjet paditësit B.M dhe të paditurës, gjykata vërtetoi faktin se paditësi ka kontratë pune me të paditurën dhe i njëjti është i sistemuar në vendin dhe me detyrat e punës në SH.F.M.U “Skender Kastrati” në fshatin Radostë, Komuna e Rahovecit.

Me administrimin e listës së pagës për muajin Tetor 2022, gjykata vërtetoi faktin se paditësi B.M ka përvojë pune 12 vjeçare.

Sipas dispozitës së nenit 35.8 të Kontratës Kolektive e Arsimit të Kosovës, e datës 18.04.2017, është paraparë se: Punëtorët (anëtar të SBASHK-ut), në vitet jubilarë të punësimit përfitojnë shpërblim jubilar nga punëdhënësi i fundit në vlerë: 8.1 për 10 vjet të përvojës së punës në vlerë 50 % të një page bazë. 8.2 për 20 vjet të përvojës së punës në vlerë prej 75 % të një page bazë. 8.3 për 30 vjet të përvojës së punës në vlerë të një page bazë. 8.4 për 40 vjet të përvojës së punës në vlerë prej 150 % të një page bazë. 8.5 Shpërblimet jubilarë paguhen nga punëdhënësit ku i punësuar ka plotësuar kushtet e shpërblimit sipas kriterëve përkatëse. 8.6 Shpërblimi jubilar paguhet në rastin e 7 Marsit të çdo viti”.

Gjykata me rastin e vendosjes, jashtë seancës gjyqësore, është bazuar në dispozitën e nenit 398 të LPK-së, e cila dispozitë përcakton se “Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritator, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë”.

Në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar dhe provave të administruara në këtë çështje kontestimore, gjykata ka ardhur në përfundim se, kërkesëpadia e paditësve duhet të aprovohet si në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Si përfundim gjykata vlerësoi se kjo e drejtë i takon paditësve në kuptim të dispozitave të lartcekura, për çka dhe vendosi që kërkesëpadinë e paditësve ta aprovojë si të bazuar dhe e detyroi të paditurën që paditësve t’ia paguajë kompensim për shpërblimin jubilar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Duke vërtetuar në këtë mënyrë gjendjes faktike me prova materiale bindëse, e duke u mbështetur në dispozitat e nenit 35.7 të Kontratës Kolektive e Arsimit të Kosovës, kjo gjykatë, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimin mbi kamatën, gjykata e mori në kuptim të nenit 382, të LMD-së.

Vendimin mbi shpenzimet procedurale, gjykata e mbështeti në harmoni me dispozitat e nenit 452.1 të LPK-së, dhe vendosi që e paditura t’ia kompensoj paditësve shumën prej 229.00 €, e që kanë të bëjnë: për përpilimin e padisë shumën prej 208.00 €, për taksën gjyqësore shumën prej 21,00 €.

**GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA RAHOVEC**  
**C.nr.504/2023, më 26.03.2024**

**Gjyqtari**  
**Betim Behluli**

**UDHËZIM JURIDIK:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 7 ditëve nga dita e pranimit. Ankesa dërgohet përmes kësaj gjykate, për gjykatën e Apelit në Prishtinë – divizionit civil.